



DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVO CUSTOMS

13.10.2023 DALJE - IZLAZ - PASSING

No/BrNo 01/1148/2023

Drejtori Qendror - Ustia Lirave - Central Administration

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

DOGANA E KOSOVËS

01

12.10.2023

PRISHTINË

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 8 pika g) të Kodit Doganor dhe të Akcizave Nr. 03/L-109 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099, nenit 37, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave personale, Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës sjellë këtë:

V E N D I M

1. Zyrtarja, znj. Gyltene Sylja, caktohet Zyrtare përgjegjëse në Doganen e Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave personale.
2. Zyrtarja nga pika 1. e këtij vendimi për Mbrojtjen e të Dhënave personale, kryen detyra të përcaktuara me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në veqanti por jo vetëm ato të parapara me nenin 39 të ligjit nr. 06/L-082.
3. Zyrtarja përgjegjëse bashkëpunon dhe vepron si pikë kontakti me Agjencinë për Informim dhe Privatësi.
4. Raporton drejtpërsëdrejti nivelit më të lartë menaxherial/Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës së Kosovës.
5. Në përmbushje të detyrave të saj i nënshtrohet fshehtësisë ose konfidencialitetit.
6. Kryen edhe detyra të tjera, nëse të njejtat nuk rezultojnë me konflikt interesi.

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi Nr.1, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax + 383 (0) 38 540 350 / +383 (0) 38 540 836

www.dogana-ks.org

Ar sy et im

Dogna e Kosovës në referim të rregullatives juridike në fuqi respektivisht Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave personale, e me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të parapara me nenin 37 të ligjit, përmes këtij akti formal, cakton Zyrtaren përgjegjëse, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Me rastin e caktimit të Zyrtares së cekur në piken një të dispozitivit të këtij vendimi për të qenë Zyrtare përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale, Drejtori i Përgjithshëm mori për bazë profilin, performancën, përgatitjen profesionale si dhe kredibilitetin e saj, e në veqanti njohuritë lidhur me organizimin, strukturën dhe veprimtaritë tjera në kuader të Doganës, duke vlerësuar njëkohësisht se zyrtarja në fjalë plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për ushtrimin e kësaj detyre.

Drejtori i Përgjithshëm mbi bazën e të cekurave si më lartë dhe me qëllim të përmbushjes së kërkesave ligjore, si dhe kërkesës nr. prot. 02/683 të datës 14.09.2023, të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

 **Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës**
Agron LLUGALIU


Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm
- Zyrtarit Përgjegjës
- Arkivit